

Trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike”

Nga 11 deri 11 qershor të vitit 2008 në Ohër u mbajt trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike”. Trajnimin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën partnere “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.

Pjesëmarrësit patën mundësi të fitojnë me dituri teorike për procesin e decentralizimit dhe mënyrat e mundshme për menaxhimin me bashkësi multietnike. Trajnimin e realizuan Zhidas Daskalovski dhe Marija Risteska nga Qendra për Hulumtime dhe Krijimin e Politikave për pjesëmarrës nga Shkupi dhe Tetova (17 përfaqësues nga organizata joqeveritare, 9 përfaqësues nga institucione dhe 3 gazetarë). Mes tjerash, në trajnim morën pjesë edhe zëvendës Avokati i Popullit në Tetovë dhe përfaqësues nga zyra e Avokatit të Popullit në Shkup.

Gjatë trajnimit të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë aktive u kyçën me diskutime të veta dhe komentuar që kishin të bëjnë me temën. Edhe përpos qëndrimeve të ndryshme dhe perceptimeve për zhvillimin e procesit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë kishte një atmosferë konstruktive për punë dhe mundësi për shprehjen e pikëpamjeve personale nga ana e të gjithë pjesëmarrësve.

Në rendin e ditës ishte përfshirë edhe përdorimi i qëndrimeve liberale dhe liberalizmi në praktikë, teoritë multikulturale nga autorë të njohur dhe zbatimi i mundshëm i tyre në RM, të drejtat e bashkësive etnike jo shumicë në komuna, konsocializmi, qasjet integruese në shoqëritë me karakter multietnik të popullatës, ndarja formale dhe joformale e fuqisë dhe ndarja e fuqisë në Ballkan. Pos sqarimeve teorike u punua edhe në grupe me shkëmbim të qëndrimeve dhe një diskutim final i cili dha një pasqyrë komplete për zbatimin e koncepteve të menaxhimit me bashkësi multietnike në nivel nacional dhe lokal.

Trajnimi u mbulua nga redaksia boshnjake dhe vllahe pranë Televizionit të Maqedonisë.